



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:093833

Datë: 15.01.2024

Numri i dokumentit: 05189317

Cnr.567/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.Sh, me seli në Mitrovice, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gjejlan Pasoma, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimi i tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 15.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. K. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F. Sh., me seli në Mitrovice, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit me rastin e pensionimit ti paguaj 3 (tri) paga përcjellëse ne shumen prej 1.416.75 euro me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë (18.05.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 104.00 €, si dhe ne emër te taksës gjyqësore 20.00€, të gjitha këto ti përmbush në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate, me datë 18.05.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti për pagesën e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit.

Në padi ka theksuar se paditësja ishte e punësuar pranë SHML ”B. I. ” në M. si mësimdhënës ne Institucionin e lartcekur. Tutje e njëjta ka theksuar se paditësit nuk i’u është bërë kompensimi për pagesën e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit edhe pse janë plotësuar kushtet e

përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e njëjta me ane te përgjigje ne padi te datës 18.12.2023 ka pohuar padinë ne kuptim objektiv dhe ka kërkuar kompensimin ne emër te pagës përcjellëse me rastin e pensionimit pas mbushjes se moshës 65vjeçare, dhe atë për paditësen A. K. ne shumën e përgjithshme në lartësi prej 1.416.75€(3x 472.25€=1.416.75€), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë (18.05.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumen prej 104.00 €, si dhe ne emër te taksës gjyqësore shumen prej 20€.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprakë te padisë ka nxjerr aktvendim për përgjigje ne padi C.nr.567/21 te datës 06.12.2023, duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit te aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes.

E paditua aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datë 11.12.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës), e njëjta në përgjigjen në padi te paraqitur me datën 18.12.2023 ka theksuar meqenëse paditësja ka bashkangjitur prova me ane te te cilave vërteton se ka qene i punësuar pranë te paditurës dhe ka bashkangjitur prova me ane te cilave dëshmojnë periudhën kohore gjate se cilës e ka kërkuar kompensimin për pagesën e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit, andaj ne baze te kësaj e paditura e pohon kërkesëpadinë e paditësit dhe kërkon nga gjykata qe te njëjtën ta aprovojë ne tersi si te bazuar.

Gjykata pas pohimit te padisë dhe kërkesëpadisë se paditësit nga ana e te paditurës me përgjigje ne padi te dhëne me dt.18.12.2023 konstatoj se kërkesa është e disponushme për palët dhe nuk është e njëjta ne kundërshtim me dispozitën ligjore te nenit 3 te LPK –se.

Prandaj gjykata ne kuptim te nenit 148 par. 1 te LPK –se me te cilin përcaktohet se: ” *Ne qofte se i padituri deri ne përfundim te shqyrtimit kryesor te çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim te mëtejme, aktgjykim me te cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim ne baze te pohimit)*” dhe gjykata vendosi pa shqyrtim te mëtejme si ne piken I te dispozitivit te këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ne pike I te dispozitivit te këtij Aktgjykimi lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, e në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, e llogaritur nga dita e paraqitjes se padisë datë 18.05.2021.

Gjykata vendosi si në piken II te dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së ashtu që e detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumen në lartësi prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK, si dhe ne emër te taksës gjyqësore shumen prej 20€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.567/21, datë 15.01.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.